



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Pro & Co Group" Sh.P.K. të datës 24.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 18.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 18.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therrtores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Pro & Co Group" Sh.P.K. e datës 24.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 18.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 18.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therrtores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Pro & Co Group" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. **Vendimi** hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Pro & Co Group" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 24.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 18.07.2023 dhe dosjes së tenderit të datës 18.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therrtores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet kryesore të parashtruesit janë cituar si në vijim:

- *“Sa i përket certifikimeve ju si AK nuk do duhej të kërkonit certifikime apo edhe trajtime ditore për qëllim favorizimi të operatorit ekonomik të caktuar pasi që këto certifikime nuk ju garantojnë për kualitet përkundrazi mund të ju implikojnë në përgjegjësi të tjera përgjatë vlerësimit apo edhe realizimit të kontratës... Natyra e aktivitetit të prokurimit ka të bëjë me realizimin e punëve dhe nuk ka të bëjë as me shërbime as me furnizime rrjedhimisht kërkesa për autorizim nga prodhuesi për pozicione të caktuara të paramasës dhe parallogarisë, katalogu i prodhuesit për pozicione, garancinë e prodhuesit për pozicione, deklarata apo test raporte dhe ISO certifikata nga prodhuesi për pozicione të caktuara është shkelje e LPP... Pra ju si AK çështjet e autorizimeve, ISO certifikimeve dhe të gjitha ato të lartë përmendura në kuptim të nenit 28 paragrafit 10 mund t'i bëni pjesë të specifikacionit teknik ...”.*

Duke u mbështetur te pretendimet ankimore si më sipër, parashtruesi ka kërkuar nga autoriteti kontraktues që të miratohet si e bazuar kërkesa e tij për rishqyrtim ashtu që të anulohet në tërësi ky aktivitet i prokurimit.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese që të bëjë vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore të parashtruesit. Rrjedhimisht me datë 25.08.2023 njësia kërkuese ka dërguar përgjigjen ku nuk është rekomanduar miratimi i kërkesës për rishqyrtim dhe ndër të tjera është potencuar se *standadat e kërkuara për ndërtimin e therrtores në dosjen e tenderit janë të ndërlidhura me natyrën specifike dhe ndjeshmërinë që ka ky aktivitet qoftë për ambientin për rreth apo edhe më pastaj në realizimin e punëve.*

Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese. Sidoqoftë, përmes nenit 60 paragrafit 60.3 nënparagrafët f) dhe h) përcaktojnë se kërkesa për rishqyrtim ndër të tjera duhet të *“përshkruan rrethanat faktike që përbëjnë apo prodhojnë shkeljen e pretenduar”* si dhe *“përshkruan se si është shkaktuar shkelja e pretenduar apo kërcënon të shkaktoj dëm material parashtruesit të ankesës...”*. Në rastin konkret në mënyrën se si janë formuluar pretendimet ankimore parashtruesi thjesht ka thënë se shumica e kërkesave në dosjen e tenderit duhet të largohen sepse nuk janë në përputhje me LPP. Me këtë rast parashtruesi askund nuk ka përshkruar rrethanat faktike që përbëjnë apo prodhojnë shkeljen e pretenduar dhe as nuk ka arritur që të përshkruaj se si është shkaktuar shkelja e pretenduar sipas tij apo si kërcënon që të shkaktoj dëm material parashtruesit. Në mungesë të këtyre sqarimeve të domosdoshme është gjetur se pretendimet ankimore si të tilla nuk janë formuluar në përputhje me dispozitat e cituara më sipër të RRPP.

Sa i përket pjesës së pretendimit ku parashtruesi aludon se autoriteti kontraktues nuk ka të drejtë që të kërkojë certifikata të caktuara pasi që sipas tij këto certifikata nuk e garantojnë cilësinë e projektit, fillimisht duhet thënë se ky pretendim është kundërthënë por edhe i palogjikshëm në tërësi. Këto kërkesa të autoritetit kontraktues janë vendosur në përputhje të plotë me nenin 64 deri 72 et. al të LPP. Si shembull mund të citohet neni 64 i LPP ku thuhet se *"Një kandidat ose tenderues do të dëshmoj me certifikatë, vërtetim apo dëshmi të tjera të mjaftueshme të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues..."*. Tutje mund të citohet edhe neni 67 paragrafi 2 i LPP ku thuhet se *"Autoriteti kontraktues e s'kualifikon çdo kandidat ose tenderues që nuk paraqet: (i) certifikatat ose dëshmitë e nevojshme për të treguar ose konfirmuar se ai nuk shkualifikohet sipas nenit 65 të këtij ligji, (ii) certifikatë, dokument ose ndonjë provë tjetër të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme kërkohet nga autoriteti kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji me qëllim të verifikimit të përshtatshmërisë profesionale të kandidatit ose tenderuesit, ose (iii) prova të mjaftueshme, sipas nenit 68 dhe 69 të këtij ligji, që në mënyrë të arsyeshme tregojnë së kandidati ose tenderuesi i plotëson kushtet minimale financiare, teknike dhe profesionale të përcaktuara në dosjen e tenderit ose në njoftimin e kontratës"*. Pra pretendimi se autoriteti kontraktues nuk ka të drejtë të kërkojë certifikata të caktuara nga tenderuesit jo vetëm që është në kundërshtim të plotë me LPP por formulimi si i tillë është edhe joprofesional dhe aspak logjik. Ngjashëm është edhe pjesa e pretendimit ankimor ku thuhet se autoriteti kontraktues nuk ka të drejtë të kërkojë dëshmi të tjera dokumentare siç janë deklaratat e prodhuesit, katalogu, etj. Fillimisht duhet sqaruar se autoriteti kontraktues nuk mund të bëjë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve nëse tenderuesit nuk dorëzojnë dëshmi dokumentare për kërkesat e dosjes së tenderit. Pra pretendimi i parashtruesit se nuk lejohet të kërkohen dëshmi dokumentare është po ashtu jologjik dhe jologjik. Ndërsa pjesa e pretendimit ku thuhet se ky aktivitet i prokurimit është për të lidhur kontratë të punës dhe jo kontratë të shërbimit apo furnizimit, duhet cekur se nuk është pretendim i saktë. Padyshim se në natyrën e projektit dominon aspekti i punës mirëpo në këtë aktivitet kërkohen edhe furnizime të caktuara që janë në shërbim të punës që do të kryej tenderuesi fitues. Mirëpo nëse parashtruesi nuk e ka kuptuar mjaftueshëm natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, vlen të theksohet që sipas LPP tenderuesit kanë të drejtë të kërkojnë sqarime shtesë nga autoriteti kontraktues në formën dhe sipas afateve të përcaktuara me LPP.

Në një pjesë të kërkesës për rishqyrtim parashtruesi ka potencuar se *kërkesat e përcaktuara për këtë aktivitet të prokurimit nuk janë përcaktuar nga autoritetet tjera kontraktuese për aktivitetet tjera të prokurimit*. Duhet cekur se të gjitha kërkesat në dosjen e tenderit janë përcaktuar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi. Megjithatë projekti për të cilin po zhvillohet ky aktivitet i prokurimit përkatësisht ndërtimi i një therrtoreje publike në këto përmasa dhe me këto standarde nuk është bërë asnjëherë më parë në shtetin e Kosovës dhe as në vendet e rajonit. Pra bëhet fjalë për një projekt mjaft të madh dhe mjaft të rëndësishëm i pari për nga lloji dhe natyra në vendin tonë. Në këtë drejtim edhe kërkesat e dosjes së tenderit janë propocionale sipas LPP pasi që për autoritetin kontraktues është e domosdoshme që një projekt i tillë të realizohet me efikasitet të plotë dhe sipas standardeve moderne për shëndetin publik dhe mbrojtjen e ambientit. Vlen të theksohet fakti se dy institucione kompetente siç janë KRPP dhe

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit e kane monitoruar këtë aktivitet te prokurimit duke analizuar dosjen e tenderit ne tersi ku kane lëshuar edhe rekomandimet e tyre ndërsa ne si AK kemi respektuar në tersi rekomandimet dhe tashme është gjithçka në rregulle.

Ajo që duhet potencuar me shumë rëndësi është fakti se kjo kërkesë për rishqyrtim është drejtuar kundër dosjes së tenderit në përmbajtjen që ka pasur para datës 18.08.2023. Mirëpo autoriteti kontraktues me datë 18.08.2023 ka korrigjuar dosjen e tenderit sipas formularit për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara duke bërë edhe ndryshim/plotësimin e kërkesave të dosjes së tenderit sipas LPP dhe RRPP. Në këtë mënyrë një pjesë e madhe e kërkesave të cilat potencohen nga parashtruesi në kërkesën për rishqyrtim tanimë nuk ekzistojnë fare në dosjen e korrigjuar të tenderit. Vlen të thuhet se kërkesat e mbetura në dosjen e korrigjuar të tenderit janë kërkesa vetëm minimale për të garantuar cilësinë dhe efikasitetin e projektit në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Sidoqoftë, nga sa u tha më sipër rezulton parashtruesi nuk e ka përcjellur fare këtë zhvillim gjatë aktivitetit të prokurimit dhe për pasojë nuk ka arritur që kërkesën e tij për rishqyrtim t'a drejtoj kundër dosjes së tenderit që është në fuqi aktualisht në kuptim të nenit 59 paragrafit 59.1 të RRPP. Me këtë rast duhet cituar nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin b) të RRPP ku thuhet se autoriteti kontraktues do të refuzoj një kërkesë për rishqyrtim nëse *“kërkesa nuk është paraqitur kundër një njoftimi ose vendimi siç referohet në nenin 59.1 të kësaj rregullore”*.

Parashtruesi ka kërkuar nga autoriteti kontraktues që të miratohet si e bazuar kërkesa e tij për rishqyrtim ashtu që të anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit. Pra parashtruesi nuk ka kërkuar që të ndryshohet/plotësohet një kërkesë e caktuar e dosjes së tenderit por sipas kërkesës për rishqyrtim shumica e kërkesave të dosjes së tenderit nuk janë të përshtatshme për parashtruesin prandaj sipas tij duhet të anulohet në tërësi aktiviteti. Së këndejmi duhet cekur se përmes RRPP janë përcaktuar saktësisht situatat në cilat mund të anulohet një aktivitet i prokurimit para hapjes së tenderit. Konkretisht përmes nenit 43 paragrafit 43.8 të RRPP është përcaktuar si në vijim:

“Procedura e prokurimit para hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyet e mëposhtme:

- a) për shkak të ngjarjeve të demonstrueshme dhe / apo arsyeve që janë jashtë kontrollit të AK dhe se nuk ishin të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve;*
- b) nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedurës ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm;*
- c) është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar, brenda kontrollit dhe domenit të KRPP-se dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP;*
- d) nëse është paraqitur pamundësia e përdorimit të platformës elektronike nga të gjithë përdoruesit si pasoje e problemeve teknike jashtë kontrollit dhe domenit të KRPP-se dhe AK dhe verifikimit e konstatimit nga KRPP-ja”.*

Në pretendimet ankimore askund nuk është argumentuar se është përmbushur të paktën një nga rrethanat e përcaktuara për anulimin e aktivitetit të prokurimit para hapjes së

tenderit në kuptim të nenit 43 paragrafit 43.8 të RRPP. Në fakt kjo dispozitë ligjore as që është përmendur diku në kërkesën për rishqyrtim të parashtruesit. Pra në njëërën ose tjetrën formë as për vet parashtruesin nuk është kontestues fakti se nuk janë përmbushur rrethanat për anulimin e aktivitetit të prokurimit në këtë fazë. Prandaj kërkesa e tij për anulim të aktivitetit sipas pretendimeve ankimore të elaboruara më sipër, rezulton se më tepër ka për qëllim zvarritjen e procedurës së prokurimit sesa mbrojtjen e interesave të parashtruesit si tenderues potencial.

Sidoqoftë, nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij dhe nuk ka paraqitur fare argumente ose prova për të mbështetur kërkesën e tij për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj edhe kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 29.08.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.